

**RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR FALJEN E GJOBAVE TË VENDOSURA NGA AUTORITETI KOMBËTAR I
USHQIMIT NDAJ OPERATORËVE TË BIZNESIT USHQIMOR”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Qëllimi i projektligjit është lehtësimi i barrës së operatorëve ekonomikë që kanë aktivitet kryesor prodhimin, përpunimin dhe shpërndarjen me shumicë të ushqimeve si dhe shitjen me shumicë të prodhimeve shtazore, të cilët janë gjobitur nga AKU-ja pasi nuk kanë qenë të licencuar për ushtrimin e aktivitetit në momentin e kryerjes së kontrollit, por që aktualisht janë pajisur me licencën përkatëse, sipas legjislacionit të licencimit.

**II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Në periudhën korrik – gusht 2019, në përmbushje të misionit të vet dhe në bashkërendim me institucione të tjera në kuadër të përpjekjeve për të rritur shkallën e zbatimit të ligjit dhe të reduktimit të informalitetit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka ndërmarrë inspektime në të gjithë vendin. Midis të tjerash ka inspektuar edhe operatorë ekonomikë që kanë aktivitet kryesor prodhimin, përpunimin dhe shpërndarjen me shumicë të ushqimeve si dhe operatorë ekonomikë që kanë aktivitet kryesor shitjen me shumicë të prodhimeve shtazore.

Këto inspektime janë shoqëruar edhe me vendosjen e gjobave në përputhje me përcaktimet ligjore të legjislacionit në fuqi për ushqimin dhe sigurinë ushqimore.

Një pjesë e konsiderueshme e vendosjeve të gjobave është lidhur me mungesën e pajisjes së operatorëve ekonomikë me lejen e veçantë të ushtrimit të llojit të aktiviteti sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.05.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.

Më konkretisht, në nënkategoritë e parashikuara në Aneksin 1 të saj;
a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;
b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B

Nga kontaktet që unë si deputet kam pasur me operatorë të ndryshëm ekonomikë të biznesit ushqimor të cilat më kanë shprehur shqetësimin për gjobat e vendosura dhe bllokimin e aktivitetit, këta të fundit janë shprehur se kanë qenë të painformuar për detyrimin e pajisjes me këto leje të veçanta.

Ndërkohë nga të dhënat e marra nga Qendra Kombëtare e Biznesit rezulton se:

Për licencën e tipit II-1- A nëse në periudhën korrik – gusht 2018 janë bërë 79 kërkesa për pajisje me licencë, ndërsa në periudhën korrik – gusht 2019 janë bërë 808 kërkesa për të njëjtën licencë

Për licencën e tipit II-1- B nëse në periudhën korrik – gusht 2018 janë bërë 52 kërkesa për pajisje me licencë, ndërsa në periudhën korrik – gusht 2019 janë bërë 607 kërkesa për të njëjtën licencë

Po nga të dhënat e marra nga QKB, rezulton se më shumë se 75 % e kërkesave të periudhës korrik – gusht 2019 janë miratuar.

Numri 10 herë më i lartë kërkesave në verën e 2019 krahasuar me verën e 2018 dhe miratimi në 2019 i më shumë se 75 % të kërkesave dëshmon se në shkallë shumë të lartë moszbatimi i ligjit nga operatorë të ndryshëm të biznesit ushqimor ka pasur si motiv kryesor mungesën e informacionit.

Për sa më sipër, propozoj që gjobat e vendosura nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për operatorët ekonomik të biznesit ushqimor në periudhën 1 korrik 2019 deri në 31 gusht 2019 të falen.

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Ky projektligj nuk synon përafrim me legjislacionin e BE-së.

V. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji hartohet në mbështetje në neneve 81 pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën

DEPUTETI PROPOZUES

Ilir BEQAJ